



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 431 /2022
Data:19.01.2022

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e njëmbëdhjetë -XI- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.12.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës (Mehmet Ballazhi), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtorja për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Arsim Dernjani** (Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh për Administratë), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Bajrush Laçi** (Shef i Zyrës Ligjore), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës).
Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. **Betimi i anëtarit të ri të kuvendit të komunës z.Veton Ballazhi.**
2. **Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.**
3. **Propozim vendimi për përbërjen e komitetit për politik e financa.**
4. **Propozim vendimi për përbërjen e komitetit për komunitete.**
5. **Propozim vendimi për përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**
6. **Shfuqizimi i vendimit me numër 01/ Nr.8749/2021.**
7. **Të ndryshme.**

Kryesuesi thekson:- për pika e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Kryesuesi thekson:- para se me procedura me pikat e rendit të punës kërkoj nga partitë politike që t'i propozojnë shefat e grupeve parlamentare.

Xhevahir Dernjani thekson:- në emër të grupit parlamentarë të PDK-së për shef grupit parlamentarë propozojmë z.Resul Suma.

Ajnure Thaçi thekson:- në emër të grupit parlamentarë të LVV-së për shef grupit parlamentarë propozojmë z.Sherif Berisha.

Refet Kalisi thekson:- në emër të grupit parlamentarë të LDK-së për shefe të grupit parlamentarë propozojmë znj.Hyriete Isufi.

Qamush Brava thekson:- në emër të grupit parlamentarë të AAK-së për shef grupit parlamentarë propozojë a.Zaim Bela.

1. **Betimi i anëtarit të ri të kuvendit të komunës z.Veton Ballazhi.**

Veton Ballazhi thekson:- betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të komunës së Hanit të Elezit , në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

2. **Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.**

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- situata rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit është stabile. Ministria i ka njoftuar qytetarët të cilët i kanë marr dozën e dytë të vaksinës se mund ta marrin edhe dozën e tretë. Edhe pse nuk kemi pasur ndonjë rast të shënuar me kovid -19 fluksi i pacientëve është rritur gjatë dy javëve të para të këtij muaji për shkak të gripit sezonal , mirëpo për momentin është qetë situata me gripin sezonal . Si drejtori jemi përgatitur dhe i kemi marr të gjitha masat në rast të paraqitjes së rasteve me virusin omikron dhe jemi duke bërë apel te ata qytetarë të pakët të cilët kanë mbetur pa u vaksinuar që të marrin vaksinat. Deri më tani janë vaksinuar 8666 qytetarë e që prej tyre me një dozë janë vaksinuar 4618 qytetarë, me dy doza janë vaksinuar 4048 qytetarë , ndërsa me dozën e tretë janë vaksinuar 11 qytetarë. Nga data 14 dhjetorë sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë ka filluar vaksinimi për moshat nga dymbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjet dhe interesimi është shumë i vogël dhe deri më tani janë vaksinuar 57 nxënës. Në bashkëpunim me ekipin e vaksinimit ishim nëpër të gjitha shkollat, që të takohemi me të gjithë drejtorët e shkollave që ta sensibilizojmë çështjen vaksinimit .

Refet Kalisi thekson:- qytetarët të cilët i kanë marr dy doza të vaksinave a informohen apo duhet me u paraqitur vetë për me marr dozën e tretë të vaksinës.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- Ministria e Shëndetësisë i paralajmëron përmes mesazheve në telefon dhe për derisa e kanë kaluar periudhën tre mujore është mirë me u lajmëruar për me marr edhe vaksinën e tretë në mënyrë që me u përforcuar shëndeti.

Kryesuesi thekson:- kërkojë nga asamblistët dhe stafin kryetarit të komunës që të gjithë të jenë të vaksinuar sepse jemi persona publikë dhe mund të kemi ndonjë kontroll prej nivelit qendrorë për çështje të vaksinave. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

3. **Propozim vendimi për përbërjen e komitetit për politik e financa.**

Kryesuesi thekson:- paraprakisht kemi biseduar me grupet parlamentare dhe jemi dakorduar edhe për kuotën gjinore. Kërkoj nga grupet parlamentare që t'i propozojnë anëtarët e tyre për në komitet për politik e financa.

Resul Suma thekson:- në emër të grupit parlamentarë të PDK-së për anëtare të komitet për politik e financa propozoj znj.Ibadete Kalisi.

Ajnure Thaçi thekson:- në emër të grupit parlamentarë të LVV propozoj z.Sherif Berisha për anëtarë të komitet për politik e financa.

Hyriete Isufi thekson:- nga radhët e LDK-së do të shkojmë me rrotacion në dy vitet e para do të jetë z.Refet Kalisi dhe pas dy viteve do të jetë znj.Hyriete Isufi.

Zaim Bela thekson:- në emër të grupit parlamentarë të AAK-së për anëtare të komitet për politik e financa propozoj znj.Nora Xhoni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR POLITIK E FINACA

4. Propozim vendimi për përbërjen e komitetit për komunitete.

Kryesuesi thekson:- kërkoj nga grupet parlamentare që t'i propozojnë anëtarët e tyre për në komitet për komunitete.

Ibadete Kalisi thekson:- në emër të grupit parlamentarë të PDK-së për anëtarë të komitet për komitete propozojë z. Resul Suma.

Sherif Berisha thekson:- në emër të grupit parlamentarë të LVV për anëtare të komitet për komitete propozojë znj.Ajnure Thaçi.

Refet Kalsisi thekson:- në emër të grupit parlamentarë të LDK për anëtare të komitet për komitete propozojë znj.Hanumshahe Dibrani.

Qamush Brava thekson:- në emër të grupit parlamentarë të AAK –së për anëtarë të komitet për komitete propozojë z.Zaim Bela.

Kryesuesi thekson:- sipas udhëzimit administrativ duhet të jetë edhe një anëtarë nga shoqëri civile, andaj kemi si propozim z.Mefail Suma. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROPOZIM VENDIMI PËR PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

5. Propozim vendimi për përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- përbërja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është në kuadër të përgjegjësi të cilat i ka komuna. Përbërja e këtij këshilli është e përcaktuar sipas udhëzimit administrativ siç e kemi dërguar në material. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Zaim Bela thekson:- në propozim vendim ishte vetëm komandanti i stacionit policorë por mendoj që kontribut mund të jep edhe komandanti i stacionit policorë të vijës së gjelbërt.

Sherif Berisha thekson:- si do të bëhet përfaqësimi i OJQ-ve.

Mehmet Ballazhi thekson:- përbërja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është propozuar ashtu siç e parasheh udhëzim administrativ por ne nëse e shohim të arsyeshme mund ftojme në mbledhje që të merr pjesë. Secila OJQ mund ta ketë ndonjë përfaqësues.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR PËRBËRJEN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

6. Shfuqizimi i vendimit me numër 01/Nr.8749/2021.

Kryesuesi thekson:- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar që të shfuqizohet vendimi në fjalë. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- kuvendi i komunës e ka miratuar këtë vendim dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e ka kthyer në rishqyrtim për shkak se nuk ka qenë në kompetencë të kuvendit për me miratuar këtë vendim por në kompetencë të ekzekutivit të komunës.

Qamush Brava thekson:- vlefshmëria e MAPL-së ka ardhur negativ dhe këtu përgjegjësia duhet ta ndajmë së bashku, mirëpo para se me dërguar këtë pikë në kuvend mendim kemi pasur edhe me zyrtarin ligjorë , kështu që zyrtari ligjorë që në fillim është dashur me potencuar se kjo pikë e rendit të punës nuk hynë në kuadër të kuvendit. Sipas rekomandimeve që janë dërguar shihet që kjo pikë edhe në të ardhmen nuk duhet të procedohet në kuvend sepse sipas pikës , një, trembëdhjetë , katërbëdhjetë sqarohet se duhet të formohet një komision nga organizata buxhetore – drejtoria e financave dhe ajo organizatë ta formon një komision dhe komisioni ta bënë vlerësimin e amortizimit të loptopëve dhe atë vendim ta nënshkruan kryetari i komunës. Nëse mendoni që ai vendim është më i plotfuqishëm apo përgjegjësia me ndarë përsëri kemi mundësi me sjell në kuvend.

Mehmet Ballazhi thekson:- kemi qenë pjesë e kuvendit të komunës dhe e dimë se si ka ardhur kjo, por duhet të jemi të gjithë të pajtimit për shkak se MAPL ka kërkuar që të shfuqizohet dhe duhet ta shfuqizojmë vendimin. Pasi ka kërkuar që të shfuqizohet vendimi realisht nuk duhet të procedohet në kuvend sepse kjo është në kompetencë drejtë për drejtë të kryetarit të komunës dhe do të veprojmë ashtu siç e përcakton legjislacioni.

Sherif Berisha thekson:- nuk dua t'i a lë fajin legjislaturës së kaluar por punët është dashur me i shikuar me zyrtarët të cilët i keni në mënyrë që nëse vërehet diçka që është gabim mos me bërë kërkesa të pa nevojshme. Është mirë me pasur kujdes në të ardhmen që kërkesa të tilla mos të na përsëriten.

Bajrush Laqi thekson:- sa i përket kësaj çështje kryetarit të komunës i kam treguar se në kuvend nuk duhet të shkon kjo punë dhe ka qenë në dijeni të kryetarit por ai e ka dërguar këtu, mirëpo edhe kryetarit të ardhshëm nëse i them që kjo çështje nuk duhet të procedohet përmes kuvendit por e procedon në kuvend atëherë e procedon në përgjegjësi të vet e jo në përgjegjësi të zyrtarit ligjorë , e që do të thotë se kryetari ka qenë në njohuri.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

U MIRATUA SHFUQIZIMI I VENDIMIT ME NUMËR 01/Nr.8749/2021

1. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- ka shqetësime te qytetarët për çështje të bredhit dhe dritave , kërkoj sqarim se si ka shkuar procedura.

Refet Kalisi thekson:- a keni ndërmarr ndonjë hap për çështjen e rrymës për te çerdhja e fëmijëve për shkak se po ka ndërprerje të rrymës. Sipas informatave që kam është një gjeneratorë i ri dhe është mirë me vendosur.

Qamush Brava thekson:- mandatin e kaluar z. Mehmet Ballazhi ishte në opozitë dhe që nga fillimi ka kërkuar që të bëhet transmetimi i seancave të kuvendit të komunës dhe në mandatin e kaluar e kemi bërë përmes fesbukut. z. Mehmet Ballazhi edhe në fushatë e ka përdorë që nga seanca e parë do të bëhet transmetimi dhe nuk është bërë. Kërkoj sqarim se pse nuk bëhet transmetimi i seancave të kuvendit të komunës.

Resul Suma thekson:- pasi që ende jemi në pandemi dhe do të ishte mirë sipas mundësive buxhetore të komunës me riaktivizu AMF-në në fshatin Gorancë pasi që moti është i ftohët në mënyrë që qytetarët me i kryer shërbimet për injeksione apo infuzione.

Nora Xhoni thekson:- gjendja e krizës energjetike e ka kapluar krejt Kosovën por edhe Hani i Elezit ishte pjesë e saj, kryetarë a je në dijeni nga KEDS-in për gjendjen e energjisë se si do të vazhdon. A do të kemi reduktime të mëdha apo a ka ndonjë njoftim për çështjen e orareve të reduktimeve.

Mehmet Ballazhi thekson:- për çështjen e bredhit dhe të dekorimit të qytetit kam dhënë sqarim edhe nëpër media dhe jemi në rregull sa i përket dokumentacionit. Gjatë bisedimeve që kam pasur me kompaninë “Besa” kam dashur me bërë një marrëveshje me pagesë dhe në momentin që u njoftua që asnjë herë në Han të Elezit nuk është bërë dekorimi i qytetit, përfaqësuesit e kompanisë u dakorduan që do ta bënë falas dhe paraqiti deklaratën dhe nga komuna është pajisur me dokumentacion të nevojshëm. Është e vërtetë që kam dhënë kritika në kuptim të këshillave për me u transmetuar seancat e kuvendit të komunës, mirëpo në legjislacionin para kësaj që ishim ka qenë një vendim i kuvendit të komunës për transmetim të seancave të kuvendit të komunës por nuk është bërë asnjë herë por dikur më vonë ka filluar me telefon. Seanca inauguruese është e incizuar nga foto Dernjani, por nuk kemi mundur me u konsoliduar për shkak se zyrtari Bashkimit Sopa është në pushim e jemi ekip i ri dhe nuk kam dashur me ja ndërprerë pushimin askujt, që do të thotë nuk kam dashur me ndërhyjë për mos me u keqkuptuar në aspektin politik. Me kompaninë “Elektra” kam biseduar sepse e kanë një televizion i cili është në provë për dy muaj dhe me datë dy shkurtë e kanë promovimin dhe do t’i shikojmë mundësitë për me bërë një marrëveshje për me i transmetuar seancat. Do ti shikojmë mundësitë që me bërë riaktivizimin e AMF-së në fshatin Gorancë por është një afat shumë i shkurtë që kemi filluar me punë. Sa i përket çështjes së rrymës disa herë ju kam parashtruar kërkesë që së paku të jemi të njoftuar për orarin e reduktimeve që ta paraqesim përmes faqes së fesbukut, përmes mediave kam parashtruar kërkesë që së paku të jemi të njoftuar për çështje të reduktimeve. Gjatë kontakteve që i kam pasur në teren me punëtorët e KEDS-it ata kanë potencuar se reduktimet kanë shkaktuar ngarkesa dhe janë bërë defekte të mëdha dhe jemi duke u munduar me i rregullu.

Hisni Luri thekson:- jemi në dijeni për gjeneratorin por jemi duke i shikuar mundësit për me vendosur një stazë në mënyrë që me u bërë mirë për me qëndruar më gjatë dhe po besojë që do të bëhet mirë.

Qamush Brava thekson:- z.Bashkim Sopa po e arsyetoni por zyrtari i ka transmetuar përmes fesbukut dhe në atë mënyrë e kemi pasur por ju keni deklaruar që përmes televizionit, andaj duhet ta mbani premtimin për shkak se është interes i gjithëve

Sherif Berisha thekson:- janë duke u zhvilluar punimet për qështje të ujit por ujë të pijes nuk kemi dhe nuk jam ithtarë me ardhur me shishe dhe me kërkuar ujë, mirëpo ka ekspert për çështje të ujit dhe është mirë me marr iniciativa dhe me filluar punën me ta në mënyrë që një herë e përgjithmonë me rregulluar çështjen e ujit.

Mehmet Ballazhi thekson:- pak më herët kisha takim me përfaqësuesit e CDI-së dhe kompaninë e cila është duke i kryer punimet dhe i dhanë disa sqarime shtesë të cilat katër vite me radhë i kam kërkuar në kuvendin e komunës dhe asnjë herë nuk i kam pranuar prej kryetarit. Nga investitori dhe kompania e cila është duke i kryer punimet u potencuat që neglizhenca ka qenë nga kryetari i komunës. Në takim investitori dhe kompania e cila është duke i kryer punimet u deklaruan se në muajin qershor do të përfundojnë punimet për çështje të ujit në Han të Elezit. Me përfaqësuesit e fshatit Gllloboqicë jam takuar dhe do t'i shikojmë mundësit që me shtuar edhe pak kapacitet dhe ata kanë ofruar bashkëpunim dhe janë afër dy apo tri litra ujë në sekondë që mundë të shtohen. Përfaqësuesit e fshatit Gllloboqicë kanë potencuar që me kënaqësi do të bashkëpunojmë por jo në mënyrë klandestin siç ka vepruar kryetari i më hershëm. Në fshatin Gorancë mungon rrjeti dhe jam në kontakt me kompaninë "Sharrcem" që pompat e ujit me i funksionalizuar që mos me pasur probleme. Për momentin jemi duke u konsoliduar si struktura dhe nuk mund të themi që kemi bërë diçka në teren për shkak se tash jemi të fokusuar në çështjet administrative por do të fillojmë edhe në teren. Punë kryesit ja paraqita edhe prerjet e asfaltit të cilat i ka bërë dhe kërkoja që pasi të përfundojnë punimet të asfaltohen.

Sherif Berisha thekson:- për çështje të ujit duhet të dilet në teren për shkak se komuna jonë ka ujë të mjaftueshëm por duhet të dilet në teren me ekspertë. Unë mendoj që edhe reka e fshatit Gorancë në të ardhmen mund të shfrytëzohet për resurset ujore por duhet të hiqen ujërat e zeza të cilat derdhen në rekë.

Refet Kalisi thekson:- nuk ka qenë neglizhencë e kryetarit të komunës për çështjen e ujit por kompania ka pasur në muajin dhjetorë me i përfunduar punimet por kompani i ka neglizhuar vetë, ndërsa me CDI-në është çështje tjetër. Nga ana jonë nuk ka qenë neglizhencë për shkak se kemi dashur sa më shpejtë të kryhen punimet. Janë disa drunj dekorativ të cilët janë dëmtuar në tretuarin i cili është ka Uji i Tharët është mirë me i verifikuar dhe kompania duhet ti rregullon.

Mehmet Ballazhi thekson:- atëherë në kuvendi i kam parë që ka pas neglizhencë kurse tash i shohë dy fish më mirë me dokumentacione dhe përmes takimeve. Nëse ju kujtohet kur u kam thënë për pusët që janë gabim dhe nuk e kam pasur personale dhe janë gabim se askush nuk e ka vlerësuar që duhet të hapen puse aty për me i shtuar kapacitet dhe këtë e kanë vërtetuar personat të cilat janë marr me atë çështje të cilëve u ka shkaktuar probleme te bazenat për akumulim të ujit por ka qenë kërkesë edhe tyre që mos mu hapur ata puse por nuk e keni dëgjuar dhe nuk e di që për çfarë arsye e keni bërë.

Sherif Berisha thekson:- kërkoj nga drejtorja për shëndetësi që në seancën e radhës të na njofton për çështjen e stomatologut.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen. Ju falënderoj për kontributin e dhënë gjatë mandatit katër vjeçar.

Mbledhja përfundoi në ora 11:53

Procesmbajtësi

Azri Bushi

